



REPUBLIKË E SHQIPËRI
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI KONTABILITET

Tiranë, më _16/04/2024

Informacion për projektin “Leading Towards Sustainable Gender Equality Plans in research institutions – LeTSGEPs” për postim në faqen e webit

Universiteti i Tiranës si pjesë e konsorciumit fitues të projektit “Leading Towards Sustainable Gender Equality Plans in research institutions – LeTSGEPs” në kuadrin e projekteve Horizon 2020 realizoi me sukses rolin e tij në këtë projekt katërvjeçar i cili nisi në janar 2020 e përfundoi në Dhjetor 2023 me synimin të hartojë dhe zbatojë Plane të Barazisë Gjinore në institucionet akademike dhe kërkimore.

Projekti e zhvilloi aktivitetin me një ekip ndërdisiplinor që përfaqësonin disa departamente të Fakultetit të Ekonomisë, Departamenti i Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Ekonomiksit si dhe një përfaqësuese nga Departamenti i Shkencave Politike, Fakulteti i Shkencave Sociale, UT. Së bashku me Fakultetin e Ekonomisë, anëtarët të konsorciumit janë institucione prestigjioze nga vende të ndryshme Europiane si: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Università di Modena e Reggio Emilia, RWTH Aachen University, Cergy, University, Paris, Mathematical Institute of the Serbian Academy of Sciences and Arts, Università di Messina, Institut de Ciències del Mar, CSIC, Barcelona, Max Planck Gesellschaft.

Në muajin Mars 2024 u zhvillua takimi me përfaqësues të Komisionit Evropian, të cilët vlerësuan rezultatet e projektit në përfundim të tij. Sipas vlerësuesve projekti LeTSGEPs ka dhënë rezultate të jashtëzakonshme me ndikim të rëndësishëm e të menjëhershëm. Projekti ka patur performancë shumë të mirë duke shfaqur një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike të Planeve të Barazisë Gjinore dhe duke ofruar një mori materialesh mbështetëse, me të cilat janë zhvilluar trajnime për anëtarët e projektit, por përmes tyre janë zhvilluar trajnime edhe brenda institucioneve kërkimore me pjesëmarrje të konsiderueshme si nga personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve.

Fokusi i këtij projekti ka qenë në integrimin e Planeve të Barazisë Gjinore me Buxhetimin Gjinor. Ky ka qenë një aspekt kyç inovativ që i ka dhënë projektit vlerën e tij të shtuar dhe pozicionin unik midis palëve të interesuara dhe projekteve të tjera simotra.

Projekti i ka arritur plotësisht objektivat dhe synimet e tij për periudhën dhe të gjitha përfundimet e publikuara në kohë janë të një cilësie shumë të mirë. Planet e Barazisë Gjinore dhe paketat e

punës mbështetëse dhe përfundimet e publikuara kanë kontribuar ndjeshëm në arritjen e objektivave të LeTSGEPs dhe kanë nxitur ndryshime të qëndrueshme institucionale. Ndër rezultatet më domethënëse janë hartimi dhe publikimi i Planeve të Barazisë Gjimore, Manuali për Plane të Barazisë Gjimore të qëndrueshme, Raporti për tejkalimin e rezistencës, Përmbledhjet e Politikave dhe rekomandimet. Manuali për Plane të Barazisë Gjimore të qëndrueshme është ndër rezultatet kryesore të projektit dhe është i një cilësie shumë të lartë.

Kuadri i monitorimit dhe vlerësimit të projektit ka luajtur një rol kyç në vlerësimin e efektivitetit dhe përshtatshmërisë së Planeve të Barazisë Gjimore. Projekti është monitoruar nga RWTH, AACHEN University hap pas hapi dhe ka qenë një qasje praktike, gjithëpërfshirëse. Aktivitetet kanë kontribuar dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe përmirësimin e perspektivës së tyre të karrierës, përmirësimin e ekuilibrit gjinor në organet vendimmarrëse si dhe në forcimin i dimensionit gjinor në përmbajtjen e kërkimit.